



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

27.02.2021

Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë

TEZA 1

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Për pranimin e një oferte:

- a. Vetëm pranuesi është i detyruar të pranojë ofertën.
- b. Vetëm ofertuesi është i detyruar, pasi kushtet e tij pranohen.
- c. Si pranuesi, ashtu edhe ofertuesi bëhen të detyruar nga kontrata.
- d. Pranuesi nuk është i detyruar.
- e. Ofertuesi nuk është i detyruar.
- f. Alternativa “d” dhe “e”
- g. alternativa “a” dhe “b”
- h. asnjëra nga këto

Përgjigja e saktë është Alternativa C

2. Në cilat rrethana u ngarkohet punëdhënësve përgjegjësia për dëmet e shkaktuara të tretëve nga ana e punonjësve?

- a. Vetëm për akte të autorizuara
- b. Për të gjitha veprimet e një punonjësi
- c. Nuk mban përgjegjësi për asnjë dëm të shkaktuar nga ana e e punënjësve
- d. Për veprime të caktuara të paautorizuara
- e. Për veprimet e shkaktuara gjatë kryerjes së punës nga ana e punëmarrësit ose të lidhura ngushtë me të dhe për të cilat nuk mund të konsiderohet punëmarrësi përgjegjës.
- f. Punëdhënësi mban në cdo rast përgjegjësi për veprimet që punonjësit u shkaktajnë dëm të tjerëve.
- g. Një rrethanë e tillë nuk parashikohet nga legjislacioni.
- h. Një rrethanë e tillë regullohet rast pas rasti.

Përgjigja e saktë është Alternativa E

3. Këshilli i punëmarrësve është një detyrim i cdo shoqërie tregtare e cila ka:

- a. më shumë se 10 punëmarrës;
- b. më shumë se 20 punëmarrës;
- c. më shumë se 30 punëmarrës;
- d. më shumë se 40 punëmarrës;
- e. më shumë se 50 punëmarrës;
- f. më shumë se 60 punëmarrës;
- g. më shumë se 70 punëmarrës;
- h. më shumë se 100 punëmarrës.

Përgjigja e saktë është Alternativa E

4. Në shoqërinë komandite, nëse largohen të gjithë ortakët e kufizuar të shoqërisë, atëherë:

- a. shoqëria kolektive prishet dhe likuidohet sipas dispozitave të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;
- b. veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite mund të vazhdojë të ushtrohet në formën e një shoqërie aksionare;
- c. veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite mund të vazhdojë të ushtrohet në formën e një shoqërie kolektive;
- d. nëse mbetet vetëm një ortak i pakufizuar, veprimtaria mund të ushtrohet me statusin e tregtarit;
- e. të gjitha alternativat e mësipërme janë të mundshme;
- f. vetëm alternativa a) është e saktë;
- g. vetëm alternativat c) dhe d) janë të sakta;
- h. vetëm alternativat b), c) dhe d) janë të sakta.

Përgjigja e saktë është Alternativa G

5. Shpërndarja e aktiveve tek aksionarët e shoqërisë pas likuidimit bëhet:

- a. duke respektuar radhën e preferencës sipas Kodit Civil;
- b. duke respektuar radhën e preferencës së përcaktuar në vendimin e asamblesë;
- c. duke respektuar radhën e preferencës së përcaktuar në ligjin “Për falimentimin”;
- d. në mënyrë të barabartë mes aksionarëve, pa radhë preference;
- e. në mënyrë të barabartë mes aksionarëve që përfaqësojnë shumicën;
- f. vetëm pasi janë përmbushur detyrimet ndaj kreditorëve;
- g. të gjitha më sipër;
- h. asnjë nga të mësipërmet.

Përgjigja e saktë është Alternativa F

6. Nuk është në kompetencën e likuiduesit:

- a. hartimi i pasqyrave financiare të shoqërisë;
- b. përgatitja e bilancit;
- c. kryerja e veprimeve tregtare të reja;
- d. njoftimi i kreditorëve;
- e. t'i kërkojë gjykatës nisjen e procedurave të falimentimit;
- f. mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë;
- g. shitja e pasurive të shoqërisë;
- h. mbledhja e kontributeve të pashlyera.

Përgjigja e saktë është Alternativa C

7. Në procedurën e falimentimit, kreditorët që marrin pagesën e plotë ose të pjesshme nga debitorët e tjerë janë të detyruar të informojnë:

- a. Titullarin e QKB;
- b. Sekretarinë e Gjykatës së Apelit;
- c. Të gjithë kreditorët e tjerë;
- d. Administratorin e falimentimit;
- e. Jo më vonë se 10 ditë pas kryerjes së pagesës;
- f. Jo më vonë se 5 ditë pas kryerjes së pagesës;
- g. Alternativa “a” dhe “e”.
- h. Alternativa “d” dhe “f”.

Përgjigja e saktë është Alternativa H

8. Rezervimi i emrit në regjistrin tregtar në QKB, është i vlefshëm:

- a. Vetëm me urdhër të titullarit të QKB;
- b. Kur shoqërohet me miratimin paraprak të Ministrit të Financave;
- c. Kur bëhet me akt noterial;
- d. Për një afat prej 30 ditësh;
- e. Deri në mbylljen e shoqërisë;
- f. Për një afat prej 5 ditësh;
- g. Për një afat 1 vjeçar;
- h. Kur pas regjistrimit nuk është bërë ankim.

Përgjigja e saktë është Alternativa D

9. Gjej alternativën e sakte:

- a. Denimi me gjobe është denim plotësues
- b. Gjohat për krimet parashikohen në maksimum në shumën 5.000.000 leke
- c. Denimi me gjobe është denim kryesor
- d. Për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjoba jepet nga 50 mijë deri në 3 milionë lekë.
- e. Alternativat c dhe b

- f. Alternativat c dhe d
- g. Anjera prej tyre
- h. Te gjitha se bashku

Përgjigja e saktë është Alternativa F

10. Gjeni alternativën e sakte në lidhje me detyrimet për shërbimin dhe transferimit e parave ose të vlerave

- a. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transfertat parash ose vlerash, duhet të marrin dhe të identifikojnë emrin, mbiemrin, adresën, numrin e dokumentit të identifikimit ose numrin e llogarisë së dërguesit, përfshirë emrin e institucionit financiar nga ku niset transfertat.
- b. Informacioni duhet të përfshihet në formularin e mesazhit ose të pagesës që shoqëron transfertën.
- c. Subjektet e transmetojnë informacionin së bashku me pagesën, përfshirë edhe rastin kur ata veprojnë si ndërmjetës në një zinxhir pagesash.
- d. Për transfertat ndërkufitare subjektet financiare përfituese duhet të verifikojnë identitetin e përfituesit, nëse ky proces nuk është kryer më parë.
- e. Alternativa c dhe d
- f. Alternativa a, b dhe c
- g. Asnjera prej tyre
- h. Te gjitha se bashku

Përgjigja e saktë është Alternativa H

PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Shpjegoni kuptimin e përgjegjësisë solidare.

Zgjidhje:

- Përgjegjësia solidare tregon detyrimin e dy ose më shumë subjekteve (si palë në një marrëdhënie juridike detyrimeve) për të paguar detyrimin ose të qenë përgjegjës për plotësimin e një detyrimi.
- Përgjegjësia e përbashkët lejon palët të ndajnë rreziqet që lidhen me marrjen e borxhit.
- Përgjegjësia solidare do të thotë që më shumë se një subjekt ka përgjegjësi ligjore për të paguar një borxh ose për të përmbushur një detyrim.
- Përgjegjësia solidare rezulton nga dy ose më shumë subjekte që aplikojnë së bashku për kredi, shpesh në një ortakëri të përgjithshme.
- Nëse ndonjë nga subjektet në partneriteti lidhin një kontratë, atëherë të gjitha subjektet e tjerë që janë pjesë e të njëjtës palë janë përgjegjës.

2. Citoni dhe shpjegoni të gjitha llojet e pushimeve të pagueshme për punonjësit.

Zgjidhje:

- a. Punëmarrësi gëzon të drejtën e pushimet vjetore të paguara, të cilat përcaktohen në kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës. Pushimet vjetore nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare. Nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet. Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës.
- b. Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, kompensohet me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 për qind dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare.
- c. Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me pushim ose pagë të paktën 50 për qind më të madhe se orët shtesë të bëra ose paga normale, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratën kolektive.
- d. Në rast martese të punëmarrësit ose në rast vdekjeje të bashkëshortit /bashkëjetuesit, paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij, punëmarrësi përfiton 5 ditë pushimi të paguar.
- e. Në rast sëmundjeje të rëndë të anëtarëve të familjes, bashkëjetuesit, të paraardhësve ose të pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor, punëmarrësi përfiton jo më shumë se 30 ditë pushimi të paguar.
- f. Në rast lindjeje fëmije, bashkëshorti/bashkëjetuesi përfiton 3 ditë pushimi të paguar.

3. Cfarë ndodh nëse themeluesit e një shoqërie tregtare nuk japin kontributet e tyre në shoqëri në përputhje me afatet dhe mënyrat e parashikuara në statut?

Zgjidhje:

Themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mund të ngrejë padi në gjykatën përkatëse për dëmin e shkaktuar nga mospërbushjet e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni.

Në rast mosveprimi të përfaqësuesit ligjor brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e mospërbushjes, padia mund të ngrihet përkatësisht nga një ortak i shoqërisë kolektive ose komandite, nga një numër ortakësh të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo aksionarësh të një shoqërie aksionare, të cilët zotërojnë jo më pak se 5 për qind të tërësisë së votave në asamblenë e shoqërisë. Padia mund të ngrihet, gjithashtu, nga çdo kreditor i shoqërisë tregtare. Ortakët, aksionarët ose kreditorët duhet të respektojnë procedurat e neneve 91, 92, 150 e 151 të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Paditë duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas regjistrimit të shoqërisë tregtare.

4. Cili është qëllimi i raportit të ekspertëve në bashkimin me përthithje të shoqërive dhe çfarë duhet të përmbajë në veçanti ky raport? A mund të përjashtohet përfshirja e ekspertëve në këtë bashkim me përthithje?

Zgjidhje:

Në bashkimin me përthithje ekspertët e pavarur të liçensuar caktohen për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit.

Në kuptim të pikës 2 të nenit 217 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 ‘Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare’, i ndryshuar, ekspertët hartojnë një raport me shkrim, ku duhet të deklarojnë, ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm. Në deklarata ekspertët duhet të shprehen, në veçanti:

- a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;
- b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;
- c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur.

Përfshirja e ekspertëve, sipas këtij neni, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive që bashkohen japin miratimin.

5. Çfarë përfaqëson vlera nominale e aksioneve? Çfarë vlerash të tjera merr aksioni?

Zgjidhje:

Çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale. Vlera e përgjithshme nominale e aksioneve nuk mund të jetë më e vogël se vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe po kështu secili aksion nuk mund të emetohet nën vlerën nominale të përcaktuar në statut. Vlera nominale e aksioneve përfaqëson kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Kur shoqëria ka pasuri të tjera veç kapitalit të regjistruar, aksionet mund të emetohen në vlerë më të lartë sesa vlera nominale. Kjo shpreh edhe vlerën e shtuar të pasurisë së shoqërisë në krahasim me momentin e parë të krijimit. Pavarësisht se aksionet nuk mund të emetohen nën vlerën e tyre nominale, ato mund të shiten nga aksionarët me vlerë më të vogël se vlera e tyre nominale, në rastet kur shoqëria ka akumuluar humbje dhe vlera e tregut është më e ulët se ajo nominale. Po kështu edhe e anasjella, kur shoqëria shton pasurinë, aksioni mund të shitet ose emetohet me një vlerë më të lartë sesa ajo nominale. Në këtë mënyrë, vlera e tregut e aksionit mund të jetë e ndryshme nga ajo nominale. Vlera e tregut të aksionit varet nga pasuria e shoqërisë. Vlera nominale e aksionit është e lidhur me kapitalin e regjistruar të shoqërisë dhe pasqyron totalin e tij.

6. Ç' kuptojmë me të drejtën e parablerjes në shoqëritë aksionare dhe në cilat kushte realizohet ajo?

Zgjidhje:

Në bazë të nenit 120 të LTSHT transferimi i aksioneve mund të kushtëzohet nga pëlqimi i organeve drejtuese dhe/ose nga e drejta e parablerjes në favor të aksionarëve të tjerë, sipas përcaktimeve të Statutit.

Me të drejtë parablerje kuptojmë, nga njëra anë, të drejtën që kanë aksionarët e një shoqërie aksionare për të qenë blerës të preferuar të aksioneve që ofrohen për shitje, përpara blerësve të tjerë të jashtëm. Nga ana tjetër, detyrimin që ka aksionari i cili dëshiron të shesë aksionet e veta, që përpara se t’ua ofrojë aksionet e veta blerësve të jashtëm, t’ua ofrojë ato për blerje

aksionarëve të tjerë të shoqërisë. E drejta e parablerjes konsiderohet nga njëra anë, si një kufizim në të drejtën për të transferuar lirisht aksionet dhe nga ana tjetër, si një e drejtë e aksionarëve të shoqërisë për t'u preferuar ndaj blerësve të jashtëm për të shmangur shpërhapjen e pronësisë duke i dhënë shoqërisë formë të mbyllur. Kusht që të realizohet ky kufizim në kalimin e aksioneve është që e drejta e parablerjes apo kushtëzime të tjera duhet të jenë të parashikuara në Statutin e shoqërisë. Ato duhet të miratohen nga organet e shoqërisë dhe aksionarët dhe të përfshihen në Statutin e sh.a. Në rast se e drejta e parablerjes nuk është përcaktuar në Statut, secili aksionar mund t'i transferojë lirisht aksionet e veta tek cilido.

7. Flisni për elementët përbërës të njoftimit të procedurës së falimentimit që u jepet kreditorëve të huaj.

Zgjidhje:

Njoftimi i fillimit të procedurës së falimentimit që u jepet kreditorëve të huaj duhet:

- të tregojë një periudhë të arsyeshme për paraqitjen e pretendimeve dhe të përcaktojë vendin për depozitimin e tyre;
- të tregojë nëse kreditorët e siguar duhet të paraqesin pretendimet e tyre të siguruar;
- të përmbajë ndonjë informacion tjetër që kërkohet të përfshihet në një njoftim të tillë të kreditorëve në përputhje me ligjin shqiptar dhe urdhrat e gjykatës së falimentimit.

8. Flisni për numrin unik të identifikimit të subjektit, sipas ligjit nr.9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.

Zgjidhje:

Me regjistrimin në regjistër, subjekteve u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga QKB-ja dhe është unik për çdo subjekt të regjistruar.

Numri unik i identifikimit të subjektit është i vlefshëm për identifikimin e subjekteve, për qëllimet e regjistrimit në regjistër, për qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve fiskale, qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues.

Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit. Subjektet e regjistruara janë të detyruara të shënojnë numrin unik të identifikimit të subjektit në çdo korrespondencë të tyre.

9. Flisni për kriteret që kërkon ligji për falimentimin për t'u caktuar si administrator në procedurën e falimentimit.

Zgjidhje:

Ligji për falimentimin përcakton se, si administrator falimentimi, administrator mbikëqyrës ose administrator i përkohshëm caktohet shtetasi shqiptar, i cili zotëron një diplomë të nivelit "Master" ose të njësuar me të, në shkencat ekonomike ose drejtësi, me të paktën pesë vite përvojë pune në këto fusha dhe që është i licencuar nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit.

10. Cila është përberja e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave?

Zgjidhje:

Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka Ministrin përgjegjës për Financat, Ministrin përgjegjës për Punët e Jashtme, Ministrin përgjegjës për çështjet e Mbrojtjes, Ministrin përgjegjës për Rendin dhe Sigurinë Publike, ministrin përgjegjës për çështjet e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

Ushtrimi 1

A.B është një uzufruktar i një pjese të tokës në pronësi të L.M. Gjatë ekzistencës së uzufruktit, A.B bëri përmirësime të dobishme në tokë. Me përfundimin e uzufruktit, L.M i kërkoi A.B të hiqte përmirësimet e bëra, por A.B refuzoi, duke kërkuar që L. M t'i rimbursonte atij vlerën e shpenzimeve të kryera për përmirësimin e pronës.

- a. Çfarë është uzufrukti?
- b. A është e drejtë kërkesa e A.B ? Shpjegoni.

Zgjidhje:

a) Çfarë është uzufrukti?

- Uzufrukti është e drejta e një personi (uzufruktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë.
- Uzufruktari gëzon sendin në uzufrukt, por nuk mund të ndryshojë destinimin ekonomik që ka patur ai në fillim të uzufruktit, pa pëlqimin e pronarit.
- Në mbarimin e uzufruktit, uzufruktari mund të heqë shtesat që i janë bërë sendit, , te cilat mund të shkëputen pa e dëmtuar atë, duke e kthyer në gjendjen e tij fillestare, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

b) A.B nuk ka të drejtë të kërkojë shpenzimet e kryera sepse:

- Uzufruktari (A.B) në mbarim të uzufruktit nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për përmirësimet e bëra në send gjatë përdorimit edhe sikur të jetë shtuar vlefja e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të uzufruktit.
- Shpenzimet që nevojiten për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e tokës janë gjithmonë “në ngarkim të A.B. (i cili është uzufruktari). Vetëm riparimet e jashtëzakonshme janë në ngarkim të L.M (pronarit të tokës).

Ushtrimi 2

Kompania X kërkon të pushojë nga puna të gjithë punonjësit në departamentin e shitjeve për 24 javë dhe më pas t'i marrë ata sërish në punë gjatë periudhës tjetër të vitit. Në cilat raste mund të aplikohet një vendimarrje e tillë?

- a) Pushimet sezonale janë të pranueshme vetëm në bizneset e lidhura me bujqësinë.
- b) Për sa kohë që kompania mund të demonstrojë përmes provave të qarta se ekziston një arsye financiare për pushimin nga puna, një pushim nga puna 24 javësh është i pranueshëm.

Jepni argumentet tuaj për një nga opsionet e mësipërme, për të cilin mendoni se mund të aplikohet.

Zgjidhje:

Kontrata e përkohëshme e punës aplikohet vetëm në sektorë apo fusha të përcaktuara. Kjo vendimarrje mund të aplikohet kryesisht në ato sektorë të punës, ku proceset realizohen vetëm gjatë disa periudhave të vitit (sezoneve). Një sektor i tillë është p.sh., puna në bujqësi, e cila rregullohet me dispozita të vecanta ligjore.

Përgjigja e saktë nga dy alternativat e propozuara është: a) Pushimet sezonale janë të pranueshme vetëm në bizneset e lidhura me bujqësinë.

Ushtrimi 3

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë X ndodh që përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ndërmerr veprime që tejkalojnë kufizimet e tagrave të përfaqësimit. Këto kufizime janë miratuar nga organet përkatëse të shoqërisë por janë bërë publik në mënyra të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

A mundet që kufizimi i kompetencave të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë sa më sipër t'u kundrejtohet palëve të treta?

Zgjidhje:

Publikimi i kufizimit nëpërmjet publikimit të vendimeve të organit përkatës të shoqërisë apo statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky kufizim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Kufizimi i kompetencave nuk mund t'i kundrejtohet palëve të treta vetëm në rastin përjashtimor kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për kufizimin, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Ushtrimi 4

Në një shoqëri tregtare në të cilën është krijuar dhe funksionon një këshill punëmarrësish, pas lindjes së disa konflikteve për çështjet e informimit, shoqëria vendos të mos i informojë më ato, duke e kufizuar këtë të drejtë informimi në statutin e shoqërisë.

A mundet që shoqëria të vendosë një pengesë apo kufizim të tillë në statut. Nëse po, në cilat raste? Nëse jo apo është në shkelje, cilat janë veprimet që mund të ndërmerren nga këshilli i punëmarrësve?

Zgjidhje:

Statuti nuk mund ta pengojë apo kufizojë ushtrimin e të drejtave të informimit të këshillit të punëmarrësve të krijuar në zbatim të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe këshillit të punëmarrësve për një sistem ekuivalent informimi.

Nëse përfaqësuesi ligjor nuk pranon të japë informacionet e kërkuara, të mbështetura në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, këshilli i punëmarrësve, brenda 2 javëve pas refuzimit, mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të marrë një vendim detyrues për informimin.

Ushtrimi 5

Personi A, në momentin e themelimit të shoqërisë “B” sha vendos që të japë kontributin e tij, duke kontribuar me një apartament me të cilin kishte garantuar shlyerjen e një kredie që kishte marrë nga banka Z, por që do e shlyente shumë shpejt. Apartamenti ndodhej në një qendër biznesi që do të përdorej si zyra për shoqërinë e re.

A mund të pranohet ky kontribut nga Shoqëria “B”? Jepni të gjitha argumentet pro dhe kundër? Nëse pranohet, cila do të jetë vlera e pranueshme si kontribut?

Zgjidhje:

Në shoqëritë aksionare pranohet kontributi në para dhe në natyrë. Në parim, Shoqëria B sh.a. mund të pranojë si kontribut apartamentin e dhënë nga personi A. Në këtë rast kontributi duhet të vlerësohet nga një apo disa ekspertë të caktuar nga gjykata përkatëse, të cilët kanë kompetencat teknike të nevojshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

Por, në rastin që apartamenti është ngarkuar me barrë për shlyerjen e detyrimit ndaj bankës Z, atëherë në bazë të nenit 125, pika 2 të LTSHT, aksionarët nuk mund t'i japin shoqërisë kontribut të rënduar me barrë. Në këtë rast kontributi (apartamenti) i rënduar me barrë nuk mund të pranohet nga shoqëria B sh.a. Arsyeja është se në rastin e garancisë reale, hipotekës, së vendosur mbi apartament, rrezikohet që sendi të përdoret për të shlyer detyrimin e personit A, pra vlera reale e sendit të ofruar si kontribut nuk është ajo vlerë që përfaqëson sendi në treg. Në këto kushte, kontributi i ofruar nga aksionari është i pashlyer, pavarësisht premtimit të tij që do të shlyejë kredinë shumë shpejt. Sipas nenit 113 LTSHT kontributet në natyrë shlyhen tërësisht përpara regjistrimit, nëpërmjet kalimit në favor të shoqërisë të titullit të pronësisë së kontributit në natyrë. Kontributet që jepen nga themeluesit përbëjnë kapitalin e shoqërisë, pasurinë e saj si garanci ndaj të tretëve, pra kontributet duhet të përfaqësojnë vetëm të drejta dhe jo detyrime. Ato duhet të jenë të çliuara nga çdolloj detyrimi, përndryshe rezulton që kapitali i shoqërisë të mos jetë i plotë, i vërtetë.

Alternative:

Megjithatë, shoqëria mund të pranojë kontributin në natyrë, në atë vlerë që tejkalon vlerën e barrës së vendosur mbi sendin dhe që mund të konsiderohet si pjesë e pangarkuar me barrë. Në këtë rast ekspertët teknikë duhet të vlerësojnë vlerën e sendit, të zbresin prej saj vlerën e barrës (kredisë/detyrimit) dhe nëse diferenca rezulton pozitive, atëherë kjo diferencë mund të pranohet nga shoqëria B si kontribut, pasi është pjesë që pasqyron një të drejtë dhe jo një detyrim.

Ushtrimi 6

Shoqëria A zotërohen në masën 35% të aksioneve të saj nga Shoqëria B. Ortaku X i shoqërisë A, i kërkon shoqërisë B, t'i blejë kuotat e zotëruara prej tij brenda një afati 1 muor nga dita e kërkesës. Shoqëria B refuzon të blejë kuotat me pretendimin se ajo nuk zotëron 50% të kapitalit në shoqërinë B, e për rrjedhojë nuk e ka këtë detyrim.

A është i drejtë pretendimi i B-së? Po pretendimi i X-it? Argumentoni.

Zgjidhje:

Ortaku X ka të drejtë të kërkojë blerjen e kuotave nga shoqëria B vetëm nëse kjo e fundit është shoqëri mëmë (kontrolluese) e shoqërisë A (shoqëri e kontrolluar) (neni 208/2 LTSHT). Me qëllim që një shoqëri të konsiderohet mëmë ajo duhet të zotërojë të paktën 30% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së kontrolluar (neni 207 LTSHT). Në rastin e mësipërm shoqëria B zotëron 35% të vlerës së aksioneve, e për rrjedhojë 35% të totalit të votave të asamblesë së përgjithshme në shoqërinë A, pasi votat janë shprehje e zotërimit të aksioneve dhe shkojnë në përpjesëtim me aksionet, sepse çdo aksion mbart të drejtën e një vote (neni 147 LTSHT).

Në këto kushte pretendimi i X-it është plotësisht i drejtë. Ai ka të drejtë të kërkojë blerjen e kuotave të tij në shoqërinë e kontrolluar A, nga shoqëria mëmë B, në çdo çast. Pretendimi i tij për afatin një muor është gjithashtu i drejtë, duke qenë se ligji parashikon të drejtën për t'i kërkuar mëmës në çdo çast të blejë kuotat e zotëruara nga ortaku në shoqërinë e kontrolluar (Neni 208/2 LTSHT).

Pretendimi i shoqërisë B nuk qëndron, sepse nuk është i nevojshëm zotërimi i 50% të kapitalit të shoqërisë. Kualifikimi si shoqëri mëmë dhe bijë (shoqëri kontrolluese – shoqëri e kontrolluar) vlerësohet në momentin që njëra shoqëri zotëron të paktën 30% të totalit të votave në AP në shoqërinë tjetër.

Si përfundim shoqëria B ka detyrimin të blejë kuotat e ortakut X në shoqërinë A në çdo çast që ortaku X mund ta kërkojë, pasi ajo vlerësohet si shoqëri mëmë e shoqërisë A (nenet 207 dhe 208 LTSHT).

Alternative:

Ndërsa, në rastin kur shoqëria mëmë zotëron 90% ose më shumë të pjesëve, atëherë ajo është e detyruar të blejë kuotat apo aksionet e mbetura me çmimin e tregut brenda 6 muajve nga kërkesa (neni 212 LTSHT).

Ushtrimi 7

Shoqëria “T & T” sh.p.k është një shoqëri tregtare e regjistruar në QKB, e cila ushtron aktivitetin tregtar në fushën e “design, aplikime grafike, etj”.

Me vendimin Nr. ___, date ___ 2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së kërkuarit, hapjen e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “T&T” sh.p.k . Emërimin si administratore të falimentimit, për Shoqërinë “T&T” sh.p.k , të znj.D.B”.*

Gjatë zhvillimit të procedurës së falimentimit janë mbajtur mbledhja për raportim dhe mbledhja për verifikimin e pretendimeve, të cilat kanë përfunduar me miratimin e tabelave përkatëse të pretendimeve të kreditorëve të Shoqërisë “T&T”.

Administratorja e falimentimit njoftoi Gjykatën, për kalimin e shumës së grumbulluar në përfundim të procedurës në favor të kreditorit të vetëm të preferuar Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë. Në përfundim rezulton se nuk ka më pasuri në emër të shoqërisë dhe se shoqëria nuk ka më detyrime të paslyera.

Administratorja i kërkon gjykatës mbylljen e procedurës së falimentimit dhe c ‘regjistrimin e shoqërisë pasi vijimi i saj nuk mund të bëhet për shkak se nuk kemi vendim për riorganizim.

Jepni vlerësimin tuaj nëse duhet të mbyllet falimentimi dhe të bëhet c’regjistrimi i shoqërisë apo shoqëria pas mbylljes së falimentimit duhet të vijojë.

Zgjidhje:

Gjykata duhet të pranojë kërkesën e administratores së falimentimit dhe të vendosë mbylljen e procedurës së falimentimit dhe ç’regjistrimin i Shoqërisë “T & T” sh.p.k nga regjistri tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Kjo pasi referuar dispozitave të ligjit për falimentimin, është gjykata ajo që vendos përfundimin e procedurës së falimentimit.

Kur të gjithë kreditorët shlyhen plotësisht shpërndarja e të ardhurave pas likuidimit të pasurisë sjell prishjen e shoqërisë. Vendimi për prishjen e shoqërisë i dërgohet QKB për c’regjistrim.

Ushtrimi 8

Shtetasja A është trashëgimtare ligjore e të ndjerit BB. Shoqëria “ËËA” SHA, është shoqëri aksionare e themeluar nga shtetasi BB dhe Shoqëria “CC” SHPK, (kjo e fundit ka administrator dhe ortak të vetëm shtetasin BB).

Ka rezultuar se në korrik 2016 shtetasi BB i ka shitur aksionet e shoqërisë “ËËA” SHA, te blerësi Shoqëria e huaj “ËËA” INC. Rezulton se marrëveshja është lidhur dhe nënshkruar në USA.

Në qershor 2018, kryhet aplikimi për regjistrimin e shitjes së aksioneve dhe kalimin e Shoqërisë “ËËA” INC, si zotëruese 100 % e aksioneve të Shoqërisë “ËËA” SHA.

Shtetasja A ushtron ankim përpara QKB dhe i kërkon shfuqizimin e këtij aplikimi pasi marrëveshja është e falsifikuar dhe se aplikimi nga shoqëria e huaj është i paligjshëm pasi vetë Shoqëria “ËËA” INC, rezulton e themeluar më janar 2018, ndërkohë marrëveshja e shitjes aksioneve është bërë në korrik 2016.

QKB nuk e pranon ankimin e kryer me arsyetimin se QKB nuk vlerëson vërtetësinë dokumentacionit të paraqitur në aplikim.

Shtetasja A ankohet përsëri në QKB duke depozituar akt ekspertimi të Prokurorisë për falsifikim të marrëveshjes si dhe vendim të gjykatës për masë sigurimi duke pezulluar të gjitha veprimet e QKB mbi këtë marrëveshje për shtije aksionesh.

QKB nuk e pranon ankimin duke arsyetuar se është bërë njëherë më parë ankimi dhe s’mund të kryhet përsëri ankim kur është refuzuar njëherë.

Shtetasja A i drejtohet gjykatës duke kërkuar shfuqizimin e regjistrimit të shitjes së aksioneve të Shoqërisë “ËËA” SHA. Detyrimin për kthimin e Shoqërisë “ËËA” SHA me aksionar 50 % Shoqëria “CC” SHPK dhe 50 % shtetasen A, si trashëgimtare e të ndjerit BB.

Mbi sa më lart, jepni vlerësimin tuaj mbi kërkimet e shtetas A i dhe veprimet e QKB.

Zgjidhje:

Gjykata duhet të pranojë padinë e shtetas A dhe të vendosë shfuqizimin e regjistrimit të shitjes së aksioneve nga Shoqëria “ËËA” SHA te Shoqëria e huaj “ËËA” INC.

Detyrimin e QKB të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e Shoqërisë “ËËA” SHA me aksionar 50 % Shoqëria “CC” SHPK dhe 50 % të aksioneve shtetasen A, si trashëgimtare e të ndjerit BB.

Kjo pasi referuar dispozitave të ligjit 9723/2007, QKB ka gabuar në këtë rast pasi për regjistrimin e degëve apo zyra të përfaqësimit të shoqërive të huaja është detyrim ligjor që QKB të kërkojë dhe aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj, dokumentacioni për gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, vendimin e organit të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, etj.

Referuar këtij dokumentacioni si edhe akt ekspertimit të Prokurorisë për falsifikim të marrëveshjes si dhe vendimit të gjykatës për masë sigurimi, QKB duhet të pranonte ankesën e shtetas dhe c’regjistronte marrëveshjen e shitjes së aksioneve, e cila rezulton se është bërë në korrik 2016, ndërkohë shoqëria që i ka blerë këto aksione, rezulton se është krijuar në janar 2018.

Ushtrimi 9

Shtetasit J.M dhe A.M janë ortakë të shoqërisë tregtare “Vespa” – sh.p.k., me seli në Tiranë, me objekt, përveç të tjerave, edhe import-eksportin e kafesë, themeluar më 22.05.2008. Më datë 10.07.2010, shtetasja A.H (bashkëshortja e shtetasit J.M) themeloi një shoqëri tjetër tregtare, me emërtimin “OJAL” – sh.p.k., ortake e së cilës ishte vetem ajo. Objekti i kësaj shoqërie ishte import – eksporti i mallrave të ndryshëm. Shoqëria tregtare “OJAL” – sh.p.k. u krijua në marrëveshje midis tre shtetasve të sipërpërmendur, jo për të ushtruar aktivitetin që ishte parashikuar formalisht në aktet e themelimit të saj, por me pikësynimin që të shërbente si

hallkë ndërmjetëse për realizimin e veprimtarisë së paligjshme në fushën e kontrabandës. Për vënien në jetë të këtij pikësynimi, rreth një muaj pas pajisjes me autorizimin përkatës për Magazinë Doganore, në magazinën e shoqërisë tregtare “OJAL” –sh.p.k, që ishte marrë gjoja me qera, më 17.8.2010, nga shoqëria tregtare “Vespa” –sh.p.k., u magazinuan 223.853 kg kafe kokërr e pabluar, importuar në datat 25 shtator dhe 7 tetor 2010 nga Greqia. Magazinimi i kësaj sasive kafeja u bë si mall me regjim të ndërmjetëm, në kushtet e Magazinës Doganore, parashikuar nga kreu i IV-të i pjesës së III-të të Kodit Doganor. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria tregtare “OJAL” – sh.p.k., e gjithë kjo sasi kafeje figuronte e rieksportuar në Republikën e Maqedonisë në datat 16 dhe 29 dhjetor 2010, ngarkuar në 7 kamiona, nëpërmjet Pikës Doganore Bllatë (Peshkopi). Dokumentat në fjalë paraqisnin të dhëna të rreme në lidhje me faktin e rieksportimit të kësaj sasive kafeje. Në fakt, e gjithë sasia e kafesë që pretendohet se ishte rieksportuar në Republikën e Maqedonisë, ishte hedhur në konsum në tregun shqiptar. Dokumentat në lidhje me hyrjet dhe daljet e sasisë së kafesë nga magazina përkatëse dhe të kalimit të kësaj sasive nëpërmjet Pikës Doganore Bllatë (Peshkopi) në datat 16 dhe 29 dhjetor 2010 u falsifikuan nga shtetasit J.M, A.M dhe A.H në bashkëpunim me shtetasit A.F dhe V. M (të dy doganierë të kontrollit fizik në Doganën Tiranë), si dhe G.P, S.U dhe E. N (të tre punonjës të Pikës Doganore Bllatë). Rezulton gjithashtu e vërtetuar se punonjësit doganorë të sipërpërmendur kanë pranuar të bashkëpunojnë me shtetasit J.M dhe A.M për realizimin e veprimtarisë së tyre kriminale, përkundrajt një shpërblimi në të holla të dhënë nga këta të fundit.

- a) Sipas mendimit tuaj, në rastin e sipërpërmendur, a plotësohen kushtet për aplikimin e përgjegjësisë penale ndaj një shoqërie tregtare dhe nëse po, cilat janë parashikimet ligjore në të cilat do të bazohet aplikimi i kësaj përgjegjësie ?
- b) Për çfarë veprash penale do të mbante përgjegjësi shoqëria (shoqëritë) tregtare dhe pse? Arsyejtoni përgjigjen tuaj, duke u ndalur veçanërisht në analizën e përgjegjësisë penale të personave që veprojnë në emër të shoqërisë.

Zgjidhje:

Shoqëritë tregtare do të mbajnë përgjegjësi penale për të njëjtat vepra si personat fizikë të cilat i ka kryer veprat penale në emër të tyre. Me konkretisht në këtë rast gjen zbatim ligji LIGJ Nr.9754, datë 14.6.2007 PËR PËRGJEGJËSINË PENALE TË PERSONAVE JURIDIKË, si dhe themeli i ceshtjes zgjidhet nepermejt Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.1 date 12.03.2002. Figura e krimit të kontrabandës me mallra në regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i K.Penal dhe ajo e kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 177 i këtij kodi, nuk konkurojnë as me njëra tjetrën, as edhe me figurat e tjera të krimit të kontrabandës që përfshihen në seksionin e V të nenit të III të K.Penal në të cilin janë përfshirë krimet në fushën e doganave (nenet 171-179 të K.Penal). Figura e krimit nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, nuk konkuron as me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij. Nga sa u tha më lart, arrihet në përfundimin se figura e krimit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, është një variant i figurës së përgjithshme të krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij, e cila realizohet në një fushë specifike të veprimtarisë shtetërore sikurse është ajo e doganave dhe prandaj këto dy figura krimi nuk mund të konkurojnë me njëra tjetrën.

Ushtrimi10

S.B. si ortak dhe administrator i H. Group, ne dyqanin “E.”. Ky dyqan i shoqerise H.G. sh.p.k është pajisur me apartin POS në muajin shtator te vitit 2015. Para se të niste transaksionet me karta POS, me datë 01.10.2015, shuma kreditore në llogarinë e tregtarit H. Group “E” ishte 1,133 leke. Me datë. 03.10.2015, në POS e tregtarit H. Group, janë nisur 9 transaksione refund në shumën 10.210.000 leke, ne 5 karta të ndryshme. Në këtë datë, tregtari nuk ka kryer asnjë ttransaksion blerje. Vlera totale e aktivitetit të POS të tregtarit H. Group, me datë.03.10.2015, ka nxjerrë një dobi në vlerën 10.208.867 leke. Me datë.04.10.2015, ne POS e tregtarit H.Group, janë kryer 7 transaksione blerje në vlerën 20.605.000 lekë, me 3 nga kartat që ishin përdorur edhe me datë.03.10.2015. Transaksioni “Refund” është kryer vetëm me një kartë, në shumën 10,396,133 lekë. Me datë.05.10.2015, tregtari ka kryer 7 transaksione refund, me dy karta, në shumën 53 000 000 lekë. Vlera totale e aktivitetit të POS të tregtarit H. Group, me dt.03.10.2015, ka nxjerrë një dobi në vlerën 8 103 867 lekë. Me datë.06.10.2015, tregtari ka kryer 3 transaksione refund, në shumën 8.750.000 lekë me 3 karta. Vlera totale e aktivitetit të POS të tregtarit H.Group, me datë.06.10.2015, ka nxjerrë një dobi në vlerën 16.853.867 leke. Në dy raste “Refund” të kryera në datat 3 dhe 4 Tetor 2015, jane dërguar fonde në llogarinë e tij personale, pikërisht në llogarinë e tij rrjedhëse e cila është e lidhur me kartën e debitit. Këto fonde, S. B. i ka tërhequr në ATM153 të ndryshme në daten 6-7 Tetor 2015. Raiffeisen Bank sh.a ka qenë e detyruar të mbulojë shumën që i është kaluar me opsion “Refund”, bankave leshuese të kartave që kanë marrë fondet nëpërmjet transaksionit “Refund”. Si rrjedhoje e njoftimeve të dërguara nga ana e Raiffeisen Bank sh.a në bankat e kartëmbajtësve, deri me datë 23.10.2015, është bërë e mundur të pakesohet dëmi që i është shkaktuar bankës, pasi një pjesë e fondeve të përvetësuar në mënyrë të paligjshme janë kthyer. Aktualisht detyrimi i tregtarit kundrejt Raiffeisen Bank sh.a, si rrjedhojë e kryerjes së transaksioneve nëpërmjet opsionit “Refund” është 6,860,486.67 leke.

- a) **A konstatooni elementet e ndonje figure vepre penale ne lidhje me pastrimin e parave?**
- b) **Cilat jane masat dhe veprimet qe duhet te kryente banka ne kete rast?**

Zgjidhje:

- a) Po, konstatohen figura e vepres penale e parshikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pra te pastrimit te produkteve te vepres penale. Këto para, i pandehuri, i ka tërhequr një pjesë dhe një pjesë tjetër i ka transferuar në llogari të tjera që i përkasin atij apo personave të tjerë, me qëllim huaparaqitjen e tyre si para që nuk kanë origjinë të dyshimtë dhe pse janë produkt i veprës penale të konsumuar nga i pandehuri. Gjithashtu perkundrejt Raiffeisen Bank sh.a ka konsumuar edhe e parashikuar nga neni 136 Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit, si rrjedhojë e krijimit te detyrimit si pasoje e kryerjes së transaksioneve nëpërmjet opsionit “Refund” ne shumen 6,860,486.67 leke.
- b) Në të dy rastet do të ishte e pamundur të zbuloheshin autorët e kryerjes së kësaj vepre pa “skanimin” e ushtruar nëpërmjet vigjilencës së zgjeruar të ushtruar prej bankave përkatëse. Për këtë shkak kemi theksuar që në krye të rradhës se bashkëpunimi me autoritetet e bankave e bën shumë të thjesht kryerjen e pastrimit të parave. Pra banka duhet te ushtronte vigilance te zgjeruar sipas parashikimeve te 7,8,9,10 dhe 11 te ligjit LIGJ Nr.9917, datë 19.5.2008 “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT” ndryshuar me ligjin Nr. 33/2019.